

01-312

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-33925/25 dt. 06.03.2025, të pronarit N.P.T. “Agro-Trade” shpk. dhe investitorit N.P.T. “Agro-Trade” sh.p.k. me seli në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumë banesore me afarizëm, të emërtuar si “AGT2” dhe “AGT 3”, ndërtuar në kuadër të bllokut urban “A17” të tërësisë urbane “A”, të Planit Rregullues “Mati 1” në rrugët “Shaqir Igrishta” dhe “Arshi Pipa” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 24.07.2025, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarit N.P.T. “Agro-Trade” sh.p.k. nga Prishtina dhe investitorit N.P.T. “Agro-Trade” shpk. me certifikatë të regjistrimit ARBK 810502535, me përfaqësues Sadudin Humolli nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-33925/25 dt. 06.03.2025, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumë banesore me afarizëm, të emërtuara si “Ndërtesa AGT 2” me etazhitet 2B+P+9ET e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-209512/20 dt. 18.02.2021, dhe Vendimit 05 Nr. 351/05-211411/21 dt. 06.07.2022 mbi ndryshimin e projektit kryesor të miratuar me Vendimin e lejimit të ndërtimit, dhe “Ndërtesa AGT 3” me etazhitet 2B+P+8ET e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-167401/21 dt. 01.11.2021 në kuadër të bllokut urban “A17” të tërësisë urbane “A” të Planit Rregullues “Mati 1”, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1694-0, ZK Matičan.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Shaqir Igrishta” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 1,3, 5,7, 9, 11, 13, 15, 17, 19, 20, 21, 23, dhe rrugën “Arshi Pipa” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 2, 4, 6 dhe 14 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari N.P.T. “Agro-Trade” sh.p.k. nga Prishtina dhe investitori N.P.T. “Agro-Trade” sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810502535, me përfaqësues Sadudin Humolli, me kërkesën me 05 Nr.391/02-33925/25 dt. 06.03.2025, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së

përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumë banesore me afarizëm, të emërtuar si “Ndërtesa AGT2” me etazhitet 2B+P+9ET, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-209512/20 dt. 18.02.2021 dhe Vendimit 05 Nr. 351/05-211411/21 dt. 06.07.2022 mbi ndryshimin e projektit kryesor të miratuar me Vendimin e lejimit të ndërtimit dhe Ndërtesa AGT 3” me etazhitet 2B+P+8ET e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-167401/21 dt. 01.11.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1694-0, ZK Matëan.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-114891/24 dt. 19.12.2024 dhe 09 Nr. 391/02-114894/24 dt. 19.12.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i vend ndërtimit Agim Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Isa Nasufi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Mentor Kryeziu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetës dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Armend Kastrati; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Mevlan Ramadani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Edita Gashi; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Naser Berisha, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Agon Blakaj me nr. të licencës 205;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetës dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Sipas dëshmisë mbi pronësinë për parcelën kadastrale 1694-0, Zona Kadastrale Matëan, pronar/posedues i parcelës së lartë cekur është N.P.T. “Agro-Trade” sh.p.k. nga Prishtina, pasi që, nëndërkohë, me aktin noterial; “Aktvendim mbi shitblerjen e paluejtshmërisë” e përpiluar te noteri Isak Ademi në Prishtinë me Nr. LRP-së 6136/19 dhe Nr. REF. 1872/19, janë ndërruar pronarët/poseduesit e parcelës së lartë shënuar, dhe rrjedhimisht Certifikata e Përdorimit lëshohet në emër të të njëjtëve.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat



nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi me ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-33925/25 DT. 24.07.2025

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

